



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Prishtinë,
16-17 mars 2023
26-27 qershor 2023

KONKLUZIONET PËR UNIFIKIM TË PRAKTIKËS GJYQËSORE

Punëtori me Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil dhe Departamenti për Çështje Administrative

Më datë 16 dhe 17 mars 2023, si dhe me datat 26 dhe 27 qershor 2023, në Hotel Amazona - Vushtrri, me përkrahjen e Akademisë së Drejtësisë, është mbajtur punëtorja lidhur me unifikimin e praktikës gjyqësore, për Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil, dhe Departamentin për Çështje Administrative.

Në pjesën e parë të punëtorisë të mbajtur me datën 16 mars, kanë marrë pjesë: kryetari i gjykatës Valon Totaj, si dhe gjyqtarët Arsim Hamzaj, Gani Avdiu, Rafet Haxhaj, Lumni Sallauka, Kujtim Pasuli, Hidajete Gashi-Alaj, Naime Ahmeti, Frosina Sylejmani, Fatmir Baloku, Besnik Bislimaj, Gëzim Llulluni, Hunaida Pasuli, Halide Reka, Nora Bllaca-Dula, Besnik Feka, Liridon Maloku, Burim Shala, Nehat Idrizi, Ardian Ajvazi, Malsor Kryeziu dhe Ramiz Kuqi.

Ndërsa me datën 17 mars, kanë marrë pjesë: kryetari i gjykatës Valon Totaj, si dhe gjyqtarët Rafet Haxhaj, Gani Avdiu, Ardian Ajvazi, Besnik Feka, Liridon Maloku, Fatmir Baloku, Kujtim Pasuli, Nehat Idrizi, Burim Shala, Hunaida Pasuli, Besnik Bislimaj, Malsor Kryeziu, Frosina Sylejmani, Hidajete Gashi-Alaj, Nora Bllaca-Dula si dhe Halide Reka.

Në pjesën e dytë të punëtorisë të mbajtur me datën 26 qershor, kanë marrë pjesë: kryetari i gjykatës Valon Totaj, si dhe gjyqtarët Gani Avdiu, Rafet Haxhaj, Nora Bllaca-Dula, Halide Reka, Hunaida Pasuli, Besnik Feka, Liridon Maloku, Lumni Sallauka, Arsim Hamzaj, Frosina Sylejmani, Hajriz Hoti, Ramiz Kuqi, Fatmir Baloku, Mehmet Ndrecaj, Burim Shala, Nehat Idrizi, dhe Bujar Muzaqi.

Ndërsa me datën 27 qershor, kanë marrë pjesë: kryetari i gjykatës Valon Totaj, si dhe gjyqtarët Rafet Haxhaj, Gani Avdiu, Kujtim Pasuli, Arsim Hamzaj, Liridon Maloku, Nora Bllaca-Dula, Hunaida Pasuli, Halide Reka, Burim Shala, Fatmir Baloku, Mehmet Ndrecaj, Nehat Idrizi, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti.

Punëtorja është udhëhequr nga kryetari i Gjykatës së Apelit Valon Totaj, udhëheqësi i Departamentit të Përgjithshëm, gjyqtari Rafet Haxhaj, përgjegjësi i Divizionit Civil, gjyqtari Gani Avdiu dhe gjyqtari Arsim Hamzaj, ndërsa në cilësi të procesmbajtësit kanë marrë pjesë bashkëpunëtorët profesional Artan Xhaqkaj dhe Blendë Mjeku.

Në kuadër të kësaj punëtorie janë diskutuar shumë çështje në lidhje me pyetjet që janë ngritur, ku të gjithë gjyqtarët janë pajtuar që përafrimi i mendimeve dhe i qëndrimeve gjyqësore për këto çështje të bëhet nga vetë gjyqtarët e lartcekur.

Punëtorja ka filluar me ndarjen e pjesëmarrësve në grupe. Ndarja në grupe është bërë në atë mënyrë që në përbërjen e grupit të jetë një gjyqtar me përvojë nga gjenerata e parë, pastaj përbërja e grupit të jetë e atillë që brenda tij të jenë gjyqtarë të gjeneratës së mesme dhe të gjeneratës së fundit të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit. Secili nga grupet ka hartuar dhe ka paraqitur propozimet duke dhënë një arsytim të shkurtër se përse ka nevojë që të vihet në diskutim një propozim i tillë.

Nga pjesëmarrësit janë dhënë 23 propozime të cilat më pastaj një nga një janë vënë në diskutim dhe gjyqtarët kanë arritur pajtueshmëri të plotë se si të vendoset në të ardhmen për secilin propozim të ngritur.

Pas diskutimeve të bëra dhe pyetjeve të ngritura, me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore për këto çështje, Kolegjiumi i Gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil si dhe Departamenti për Çështje Administrative gjatë pjesës së parë dhe pjesës së dytë, të punëtorisë ka arritur që të përfundojë diskutimet dhe ka arritur që të nxjerrë konkluzionet për 23 pika të propozuara.

Kolegjiumi i Gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil si dhe Departamenti për Çështje Administrative, nga kjo punëtori ka nxjerrë këto konkluzione:

1. Në rastet kur Gjykata e Apelit, në përbërje nga gjyqtari individual, e ka refuzuar propozimin për përsëritje të procedurës si dhe i njëjti vendim është vërtetuar nga kolegji i të njëjtës gjykatë, a mund të paraqitet propozimi për përsëritje të procedurës dy herë për të njëjtën pikë, sipas afatit objektiv, apo ky propozim duhet të hedhet poshtë si i palejuar?

Konkluzion:

Pala mund të kërkojë përsëritjen e procedurës, nga të gjitha shkaqet e parapara me nenin 232 të LPK duke përfshirë faktet dhe provat e specifikuar në nenin 232 pika g të LPK, por jo për të njëjtin fakt dhe provë lidhur me të cilin është vendosur më parë me aktvendim gjyqësor të formës së prerë. Në këtë rast propozimi (i dytë) për përsëritjen e procedurës duhet të hedhet si i palejueshëm, sepse, pala gjatë gjithë procesit ka pasur mundësi që të propozojë një provë të tillë dhe një gjë të tillë nuk e ka bërë.

2. Cili Departament ka kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me Kontestet e Punës, konkretisht pagat jubilarë të shërbyesve civil - zyrtarët e ATK?

Konkluzion:

Lidhur me këtë çështje Gjykata e Apelit duhet t'i drejtohet Gjykatës Supreme të Kosovës për të kërkuar mendim juridik.

3. Si të veprohet lidhur me propozimin për masën e sigurisë, në rastet kur lënda gjendet me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë, a duhet të vendosë kolegji apo gjyqtari individual, si dhe a duhet të jepet këshillë juridike me rastin e vendosjes?

Konkluzion:

Për propozimin për masë të sigurisë të paraqitur në Gjykatën e Apelit duhet të vendosë kolegji i Gjykatës së Apelit në seancë të kolegjit pa shqyrtim të drejtpërdrejtë në bazë të gjendjes në shkresat e lëndës si dhe duke u bazuar në nenet 190 dhe 208 të LPK. Ndaj këtij vendimi nuk duhet të lejohet e drejta në ankesë.

4. Si të veprohet kur pala kërkon shpenzimet për ankesën e parashtruar dhe për përgjigjen në ankesë në rastet kur vendoset pozitivisht sipas ankesës?

Konkluzion:

Në rastet kur pala ankuese ka sukses në procedurë sipas ankesës me vendim meritator dhe ka kërkesë të specifikuar për shpenzimet e avokatit për përpilimin e ankesës dhe taksës për ankesë, pala ankuese ka të drejtë edhe në kompensimin të këtyre shpenzimeve të krijuara,

andaj kolegji i Gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit konsideron se të njëjtat duhet të aprovohen. Ndërsa përgjigja në ankesë nuk konsiderohet parashtrësë në kuptim të nenit 99 të LPK, nenit 6.1 të OAK, si dhe nenit 2.4 të UA nr.01/2017, të datës 15.03.2017, për unifikimin e taksave gjyqësore, andaj parashtruesi nuk ka të drejtë në kompensim të shpenzimeve për këtë shkresë të tij.

5. A legjitimohet trashëgimtari i të paditurit, në çështjen e propozimit për përsëritjen e procedurës kur vendimi është marrë në mungesë të paditurit i cili ka qenë i vdekur në kohën kur është parashtruar padia ose edhe gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore?

Konkluzion:

Trashëgimtari universal i palës së vdekur në procedurën kontestimore e fiton cilësinë e palës sipas fuqisë ligjore për vazhdimin e procedurës kontestimore në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me kontestet lidhur me të drejtat që mund të barten, përkatësisht ato të cilat mund të trashëgohen. Pra gjatë vazhdimin të procedurës ai e ka pozitën juridike të palës që e kishte paraardhësi i tij, me të drejtë që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale duke përfshirë edhe ushtrimin e mjeteve juridike dhe të jashtëzakonshme në kushtet e parapara me ligj (neni 280.1 LPK).

6. Pas skadimit të Kontratës Kolektive, a iu njihen të drejtat dhe detyrimet palëve sa i përket shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit?

Konkluzion:

Lidhur me këtë çështje duhet të vepohet sipas pikës IV të Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës GJ.A.40/2023, të datës 27.02.2023.

7. A mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronën shoqërore me anë të parashkrimit fitues?

Konkluzion:

Në rastin konkret nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronë shoqërore me parashkrim fitues. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LMThJP Gazeta Zyrtare RSFJ nr.6/80 (SL.List SRJ, br.29/96) nuk është ligj i zbatueshëm në Kosovë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë (vitet 98-99), çështja e legjislacionit në fuqi është e përcaktuar me nenin 1 të Rregullores së UNMIK nr.1999/24, me të cilin është përcaktuar se ligji në fuqi në Kosovë do të jetë: a) rregullorja e shpallur nga PSSP dhe instrumentet e nxjerra në përputhje me të dhe b) Ligjet që kanë qenë të aplikueshme deri me 22.03.1989. Me dispozitën e lartcekur nuk është përcaktuar si ligj i zbatueshëm edhe ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ishin në fuqi me datën 22.03.1989, edhe pse në fuqi mund të janë edhe ligjet pas kësaj date, e të cilat nuk janë diskriminuese dhe që konform me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, gjykata, organi ose personi përjashtimisht mund ta zbatojë atë ligj, në rast se një çështje nuk ka qenë e rregulluar me ligjet e datës 22.03.1989.

8. Si duhet të vepohet në rastet kur gjykata e shkallës së parë, në procedurën përmbartimore, lidhur me vendimet e Inspektoratit të Punës, ku janë cekur shumat e detyrimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, dhe tani vendimi është i plotfuqishëm dhe i

ekzekutueshëm, e po ashtu ekziston vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 16.12.2022, sipas të cilit këto vendime të inspektoratit janë të kundërligjshme?

Konkluzion:

Lidhur me këtë çështje duhet të vazhdohet procedura përbarimore sipas praktikës së deritanishme (sipas nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi.1.2 të LPP) për të gjitha vendimet e formës së prerë të Inspektoratit të Punës që është caktuar përbarimi deri me datën 16.12.2022, kur për çështjen e kompetencës të Inspektoratit ka vendosur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me aktgjykimin e saj KO27/21, të datës 16.12.2022, me të cilin aktgjykim Gjykata Kushtetuese nuk i ka anuluar në mënyrë retroaktive vendimet e tilla të Inspektoratit të Punës të nxjerra para kësaj date.

9. Në rastet pronësore kur mungojnë shënimet kadastrale të nevojshme për dhënien e mendimit apo dhënies së historiatit, ndërsa shënimet e sakta kadastrale janë në Serbi, a duhet të ndërpritet procedura dhe të pritët kthimi i dokumentacionit kadastral nga Serbia, apo të vazhdohet që të vendoset në bazë të atyre shënimeve që gjinden në shkresat e lëndës?

Konkluzion:

Me nenet 277 dhe 278 të LPK nuk është paraparë ndërprerja e gjykimit në rastet kur pala nuk mund të marr ndonjë provë, por pala mund ta realizojë të drejtën e vet me propozim për përsëritjen e procedurës në përputhje me dispozitat ligjore të LPK me të cilat rregullohet procedura sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik për përsëritjen e procedurës.

10. Sa duhet të jetë shuma orientuese për aprovimin e kërkesëpadisë lidhur me çështjet e kompensimit të dëmit sipas padisë për shpifje dhe fyerje dhe cilat kritere duhet të merren për bazë në rastin e aprovimit?

Konkluzion:

Lidhur me këtë çështje duhet të kërkohet mendim juridik nga Gjykata Supreme e Kosovës.

11. A i takon kompensimi palës paditëse në rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me vendim të kundërligjshëm pa i skaduar kontrata e punës?

Konkluzion:

Kur paditësit i është ndërprerë kontrata e punës para skadimit të saj, me vendim të kundërligjshëm të punëdhënësit, ai ka të drejtë në kompensimin e fitimit të humbur (sipas nenit 80 të Ligjit të Punës) për periudhën kohore nga momenti i ndërprerjes së parakohshëm të kontratës, e deri në skadimin e saj.

12. Në raste e caktimit të masës së sigurisë, a lejohet ankesa kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar kërkesa për lirim apo ulje nga pagesa e garancionit?

Konkluzion:

Në rastin konkret kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar kërkesa për lirim apo ulje nga pagesa e garancionit, nuk lejohet ankesë e veçantë ngase vendimi i tillë ka karakter drejtues dhe kjo procedurë nuk përfundon me vendim merititor.

13. A duhet të hedhet apo të pranohet si e lejuar ankesa, në rastet kur ankesën kundër aktvendimit të dhënë në procedurë përmbartimore sipas prapësimit e paraqet familjari i debitorit të vdekur, i cili të njëjtës ia ka bashkangjitur si dëshmi aktvdekjen?

Konkluzion:

Në rastin konkret trashëgimtari ka të drejtë të parashtrojë ankesë dhe i njëjti duhet të legjitimohet përmes aktvdekjes apo ndonjë dokumenti tjetër që dëshmon se ai është trashëgimtari i të vdekurit. Gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës përmbartimore duhet të veprojë sipas dispozitave të nenit 35 të LPP.

14. Si duhet vepruar në rastet e shpronësimit, kur ka ekspertizë apo superekspertizë nga grupi i ekspertëve, ndërsa shuma e kompensimit është shumë më e madhe në krahasim me vlerësimin e organit shpronësues?

Konkluzion:

Ekspertiza si provë për të sqaruar faktet dhe rrethanat për të cilat gjykata nuk ka njohuri profesionale, duhet të merret në përputhje me dispozitat ligjore të LPK dhe të vlerësohet në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Shpronësim, me të cilat përcaktohet se cilat kritere duhet të merren për bazë me rastin e vlerësimit të patundshmërisë së shpronësuar. Në këto raste nëse superekspertiza e nxjerrë nga grupi i ekspertëve i plotëson kushtet të cilat i ka kërkuar gjykata me aktvendimin për ekspertim dhe në raport me provat e tjera në procedurë, në parim të njëjtës duhet t'i falet besimi, pra me kusht që t'i plotësojë kushtet ligjore për vlerësim.

15. Si duhet të veprohet në rastet kur gjykata e shkallës së parë në procedurë përmbartimore, nuk cakton fare garancion ose kur e cakton garancionin por pa dëshmi për pagesën e tij, dhe lënda përcillet sipas ankesës në Gjykatën e Apelit?

Konkluzion:

Gjykata e shkallës së dytë mund të shqyrtojë ankesën pasi të paguhet shuma e garancionit në gjykatën e shkallës së parë (neni 78.5 i LPP). Nëse në shkresat e lëndës nuk ka prova se është paguar garancioni, gjykata e shkallës së dytë ia kthen me akt përcjellës çështjen gjykatës së shkallës së parë që të veprojë sipas nenit 78 të LPP, ashtu që të sqarohet çështja e pagesës së garancisë. Kjo do të vlejë si për rastet kur nga ana e gjykatës së shkallës së parë me aktvendim është caktuar pagesa e garancisë por edhe në rastet kur garancinë nuk e ka caktuar gjykata e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë nuk duhet ta përcjellë lëndën në gjykatën e shkallës së dytë pa dëshminë - dëftesën për pagesën e garancisë.

16. Si të veprohet në rastet kur ankesën e ka nënshkruar avokati në emër të palës si i autorizuar i saj, i cili ka marrë pjesë në shqyrtime por pa autorizim në shkresat e lëndës dhe si të

veprohet në rastet kur ankesa e nënshkruar nga avokati në emër të palës është veprimi i parë procedural të cilin e ka ndërmarrë ai, por nuk e ka paraqitur autorizimin për këtë veprim të tij?

Konkluzion:

Në të dy rastet gjykata e shkallës së dytë me akt përcjellës duhet t'ia kthejë lëndën gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë që e njëjta të kërkojë nga pala që t'i bashkëngjisë autorizimin, apo aprovimin e palës për veprimet procedurale të kryera nga ai (neni 93.2 lidhur me nenin 189.2 të LPK).

Rekomandim për Gjykatat Themelore:

Gjykatat e shkallës së parë, rekomandohen që të bëjnë shqyrtimin paraprak të ankesës sipas të gjitha bazave ligjore të nenit 186 LPK, në të kundërtën çështjet do të kthehen në plotësim kur vërehen mungesat siç është mos ekzistimi i autorizimit në shkresat e lëndës.

17. A mund të caktohet masa e sigurimit në rastet kur janë plotësuar dy kushtet e parapara me nenin 297 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LPK, por nuk është paguar garancioni? Si duhet të veprojë Gjykata e Apelit në këto raste?

Konkluzion:

Në rastin konkret duhet të plotësohen në mënyrë kumulative tri kushtet ligjore dhe nuk mund të caktohet masa e sigurimit pa u paguar garancioni i caktuar nga gjykata e shkallës së parë. Në të kundërtën vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të priset.

18. A mund t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm palës së paditur pa propozimin e palës paditëse në rastet kur adresa e të paditurit ka rezultuar si e pasaktë?

Konkluzion:

Në këto raste gjykata sipas detyrës zyrtare të paditurit që nuk i dihet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, do t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm kur të përmbushen kërkesat ligjore nga neni 79.3 LPK.

19. Si të veprohet në rastet kur në dispozitiv të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë nuk e ka përcaktuar në mënyrë të kurtë se çka ka refuzuar, si dhe në rastet kur gjykata e shkallës së parë vendosë sipas kërkesëpadisë së pa precizuar nga pala paditëse përkundër faktit që ka ekspertizë të gjeodezisë, e gjithashtu edhe në rastet e kompensimit të dëmit kur nuk precizohet kërkesëpadia pas ekspertizës përkatëse?

Konkluzion:

Në këto raste vendimi i gjykatës së shkallës së parë priset dhe çështja i kthehet të njëjtës në rigjykim sepse nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë objekti i kontestit respektivisht nuk është përcaktuar kërkesëpadia.

20. A duhet të përfshihen në anën e të paditurit të gjithë trashëgimtarët në rastet kur bëhet fjalë për bashkëndërgjyqësi unike apo mund të vazhdohet zhvillimi i procedurës vetëm me disa nga trashëgimtarët që janë përfshirë në padi?

Konkluzion:

Në rastin e bashkëndërgjyqësisë unike në kuptim të nenit 269 të LPK, si bashkëndërgjyqës unik në anën e të paditurit duhet të përfshihen të gjithë trashëgimtarët e trashëgimlënësit.

21. A ndërpritet parashkrimi kur kemi të bëjmë me kërkesat periodike të përcaktuara sipas nenit 360 të LMD?

Konkluzion:

Parashkrimi është institut juridik i rregulluar me ligj, të cilin as palët, e as gjykata nuk mund ta ndryshojnë. Për kërkesat e përfshira në nenin 360 të LMD, për të cilat është përcaktuar afati 1 vjeçar i parashkrimit, këto kërkesa parashkruhen pas skadimit të afatit prej 1 viti nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për parashkrim. Pra pagesa e këstit e ndërpret parashkrimin për të gjitha kërkesat për të cilat nuk ka skaduar afati 1 vjeçar por jo edhe për kërkesat për të cilat nga momenti i pagesës kanë kaluar mbi 1 vit sipas afatit të përcaktuar ligjor sepse këto kërkesa nuk përfaqësojnë borxh unik por janë kërkesa të specifikuar mujore.

22. Kush është kompetente lëndore që të vendosë lidhur me çështjet administrative që kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë për Shërbyesit Civil që burojnë nga Kontratat Kolektive?

Konkluzion:

Në këto raste kompetent është Divizioni Civil. Departamenti Administrativ do të vendosë vetëm për rastet në të cilat ka filluar procedura përmes KPMK.

23. A plotësohen kushtet për fillimin e procedurës gjyqësore administrative (konfliktit administrativ), kur organi administrativ i shkallës së dytë e anulon vendimin e organit administrativ të shkallës së parë dhe çështjen e kthen në rivendosje?

Konkluzion:

Në këto raste nuk lejohet iniciimi i padisë pasi që në rastin e anulimit të vendimit të organit administrativ të shkallës së parë nga organi administrativ i shkallës së dytë, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në organin e shkallës së parë dhe pa u vendosur nga i njëjti për çështjet lidhur me të cilat vendimi është prishur, nuk mund të vazhdohet me procedurën lidhur me konfliktin administrativ ngase me të njëjtin vendim nuk është vendosur meritorisht çështja.

Arritja e objektivave të punëtorisë

Lidhur me arsyeshmerinë e mbajtjes dhe objektivat e arritura theksojmë se punëtorinë e ka karakterizuar një frymë e lartë profesionalizmi dhe një përkushtim i theksuar, që nga puna në grupe dhe parashtrimi i propozimeve, e deri tek zhvillimi i debatit për secilën pikë të propozuar dhe arritja në konkluzionin përfundimtar për pikën e diskutuar. Debatin e ka karakterizuar një nivel i lartë i profesionalizmit dhe dhënies së mendimeve mbi zgjidhjet e ofruara, niveli i lartë i respektimit të kohës dhe mendimit të tjetrit e deri tek të vendosurit lidhur me miratimin dhe konkluzionin përfundimtar.

Për çështjet për të cilat ka pasur pajtim të plotë është vendosur me njëzëri, ndërsa për çështjet që ka pasur diskutime paksa më të gjata është vendosur me shumicën e votave.

Si përfundim i të cekurave si më lartë, vlen të theksohet se iniciativa për mbajtjen e një takimi të tillë dhe metodologjia e punës brenda punëtorisë, është vlerësuar lartë nga pjesëmarrësit për çka është ardhur në konkludim se kjo punëtori ishte tejet e suksesshme dhe se konkluzionet e nxjerra do lehtësojnë punë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit dhe jo vetëm, në të ardhmen.

Theksojmë se suksesi i arritur në këtë takim, nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen Këshillit Gjyqësor të Kosovës-KGJK, kryetarit të Gjykatës së Apelit Valon Totaj, Kolegjiut të gjyqtarëve të Departamentit të Përgjithshëm-Divizionit Civil edhe të Departamentit për Çështje Administrative.

Një falënderim i veçantë për Akademinë e Drejtësisë, për përkrahjen dhe mundësimin e kësaj punëtorie.

Nga një kopje t'u dërgohet:

*Të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Kosovës,
Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
Arkivit të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe
Akademisë së Drejtësisë*